



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



# Plani për Integritet

(2024-2026)

Prishtinë, 2023



***“Integriteti është parimi i të vepruarit vazhdimisht në përputhje me vlerat etike dhe profesionale”***

## **PËRMBAJTJA**

1. Deklarata për Integritet.....	3
2. Hyrje.....	4
3. Vendimi për emërimin e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.....	5
4. Plani për Integritet.....	7
5. Procesi i Zhvillimit të Planit për Integritet.....	7
6. Analiza e akteve normative.....	8
7. Matrica e vlerësimit të intensitetit të rrezikut.....	9
8. Monitorimi dhe Raportimi i Zbatimit të Planit për Integritet.....	10
9. Matrica e Identifikimit të Rreziqeve.....	12
10. Vendimi për miratimin dhe hyrjen në fuqi të planit të integritetit.....	19

### **FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT:**

1. Udhëheqja dhe Menaxhmenti,
2. Politika e Burimeve Njerëzore,
3. Planifikimi dhe Menaxhimi i Financave,
4. Ruajtja dhe siguria e të dhënave digjitale,
5. Prokurimi Publik i Agjencisë.

### **FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT**

1. Konflikti i interesit,
2. Deklarimi i pasurisë,
3. Dhuratat – Pranimi, regjistrimi dhe ekspozimi i tyre,
4. Sinjalizimi,
5. Integriteti,
6. Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe vlerësimi i korrupsionit në legjislacion.

## **1. DEKLARATA PËR INTEGRITET (modifikohet nga Drejtori)**

Duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gjegjësisht nenit 25, të gjitha organet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale të Kosovës obligohen që të miratojnë planet e integritetit. Ndërsa i njëjti ligj e obligon Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit për nxjerrjen e Metodologjisë uniforme dhe udhëzimet për përpilimin dhe zbatimin e Planeve të Integritetit.

Duhet theksuar që integriteti është një komponent kyç i çdo organizate të suksesshme. Ai është thelbësor për ruajtjen e besimit të publikut, parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit si dhe sigurimin e pajtueshmërisë me aktet ligjore.

Pra, plani i integritetit është një dokument që tregon përkushtimin e institucionit ndaj integritetit dhe përcakton politikat dhe procedurat që do të përdoren për të arritur këtë qëllim. Planin i integritetit duhet t'iu përshtatet nevojave specifike të organizatës, por në përgjithësi duhet të përfshijë elementët e mëposhtme: përkufizimin e integritetit dhe rëndësisë së tij, vlerësimin e rreziqeve aktuale të integritetit të organizatës, një tërësi qëllimesh dhe objektivash për planin e integritetit, politikat dhe procedurat për të adresuar rreziqet e integritetit, si dhe procesin e monitorimit dhe vlerësimin e efektivitetit të planit të integritetit.

Rrjedhimisht, integriteti i institucionit është i rëndësishëm për një sërë arsyesh. Së pari, ndihmon në ndërtimin e besimit me publikun dhe palët e interesuara sepse kur ata besojnë në institucion, ka më shumë gjasa që të ndërveprojnë me të, të kontribuojnë dhe ta mbështesin atë. Së dyti, integriteti ndihmon në parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit sepse kur punonjësit e dinë se institucioni është i përkushtuar ndaj integritetit, ata kanë më pak gjasa të përfshihen në sjellje mashtruese ose korruptive. Së treti, integriteti ndihmon për të siguruar përpunjen me ligjet dhe rregulloret sepse kur organizatat kanë politika dhe procedura të qarta, ato kanë më pak gjasa të shkelin ligjet dhe rregulloret.

Për fund, plani i integritetit përveç që tashmë është edhe kërkesë ligjore, ai është një mjet thelbësor për çdo institucion apo ndërmarrje që dëshiron të ruajë integritetin e saj të rris reputacionin dhe të mbrohet nga mashtrimi, korrupsioni dhe lëshime të tjera etike.

Le të zbatojmë obligimet ligjore dhe le të japim kontributin tonë për Kosovën pa Korrupsion!

Yll Buleshkaj,

Drejtore i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

## 2. HYRJE

Duke u bazuar në nenin 25 të Ligjit me Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, obligohen të gjitha Organet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale të Kosovës, të miratojnë plane të integritetit me qëllim të identifikimit të proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive.

Si rezultat i kësaj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2026.


Plani i Integritetit është një dokument që tregon përkushtimin e Institucionit tonë ndaj integritetit dhe përcakton politikat dhe procedurat që do të përdoren për të arritur këtë qëllim.


Plani për Integritet është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Agjencisë.

Plani i Integritetit rritet përkushtimin e Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Agjencisë dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe në vlerat dhe standardet profesionale.

Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me qëllimin që hartimi i planit për integritet të këtë një gjithë përfshirje të njësive brenda Institucionit, si dhe me qëllimin që të identifikohen rreziqet nga të gjitha këto njësi, me datë 28.09.2023, ka formuar grupin punues për hartimin e planit të integritetit për Agjencinë me një përbërje prej njëmbëdhjetë (11) anëtar.

### 3. VENDIMI PËR EMËRIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR AGJENCINË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
**AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të Nenit 12, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, Nenit 25, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me Vendimin Nr. 1476/23, të datës 26.07.2023, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.09.2023, nxjerr:

Doc. No.	01	No. Pres.	1790/23
Myq. No.		Dr. Pres.	
Dr. No.		Pres. No.	
Myq. F. No.		Data	28.09.2023
Dr. F. No.	02	Data	
No. Pres.		Data	

**V E N D I M**

**Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit**

1. Caktohet Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit, me përbërjen si në vijim:
  - a) Milot Shala – kryesues/koordinator
  - b) Burim Sadiku – anëtar
  - c) Qendresa Berisha – anëtare
  - d) Florije Retkoceri - anëtare
  - e) Mimoza Limani – anëtar
  - f) Frashër Murtezaj – anëtar
  - g) Agron Behrami – anëtar
  - h) Driton Shala – anëtar
  - i) Sebahate Jonuzi – anëtar
  - j) Besnik Dragusha – anëtar
  - k) Gani Nikqi, anëtar/përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit;
2. Obligohet grupi Punues të përgatisë një program për hartimin e Planit të Integritetit, sipas udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara me Metodologjinë për Planin e Integritetit, të aprovuar me Vendimin Nr. 1476/23, të datës 26.07.2023. Grupi Punues do të kujdeset që Plani i Integritetit të Agjencisë, të përfshijë të gjitha fazat dhe procedurat e hartimit të Planit të Integritetit, duke filluar nga qëllimi, rëndësia dhe mënyra e hartimit të Planit të Integritetit, deri tek monitorimi dhe mbikëqyrja e Planit të Integritetit.
3. Grupi i Punës përfundon hartimin e Planit të Integritetit jo më vonë se 10 nëntor 2023.
4. Obligohen të gjitha njësitë brenda Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe zyrtarët për bashkëpunim dhe ofrim të të dhënave të kërkuara nga Grupi Punues. Kryesuesi i këtij Grupi Punues, sipas nevojës, mund të kërkojë angazhim të zyrtarëve të tjerë shtesë.
5. Vendimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit.

*www.akk-ks.org | info@akk-ks.org | +383 (0) 35 518-907 +383 (00) 10-716*



### Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Prandaj, duke e marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e hartimit dhe të miratimit të Planit i integritetit, si një dokument që ka për qëllim krijimin e një mekanizmi institucional, i cili do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të funksionimit të institucionit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në këtë drejtim cakton grupin punues si në pikën 1 të dispozitivit të këtij Vendimi, i cili është përgjegjës që gjatë punës së tij të ketë parasysh detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara si në pikën 2 të dispozitivit, si dhe të veprojë konform udhëzimeve dhe procedurave standarde të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me Vendimin Nr. 1476/23, të datës 26.07.2023.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Yll BULESHKAJ

Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi i dërgohet:

- Grupit Punues;
- Zyrës së Drejtorit;
- Arkivit;

#### 4. PLANI PËR INTEGRITETIT

Plani i Integritetit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Planeve të Integritetit, i aprovuar më 26.07.2023.

Plani i Integritetit është dokument i brendshëm tre (3) vjeçar, që përcakton vlerësimin e rrezikut të korrupsionit dhe formave tjera që e cenojnë integritetin, si dhe masat parandaluese. Si i tillë, Plani shërben për identifikimin e rreziqeve, analizën dhe vlerësimin e rrezikut dhe specifikon masat, sipas rreziqeve për arritjen e objektivave të saj të integritetit, për të avancuar performancën e integritetit në sektorin e administratës publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit dhe vlerave e standardeve profesionale.

Qëllimi i Planit të Integritetit është definuar edhe në metodologjinë e planeve të integritetit:

- Identifikimi i proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive;
- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion, që synon respektimin e kërkesave ligjore, procedurale dhe kuadrit të brendshëm normativ;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike në qeverisjen dhe në performancën e integritetit të sektorit publik;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit, përmes përmirësimit të kontrolleve operacionale në fushat e funksionimit të institucionit dhe proceset e punës me rrezik korrupsioni;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion, me fokus në fushat me rrezik të lartë të cenimit të integritetit, duke synuar integrimin e këtij procesi në kulturën institucionale.

#### 5. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT PËR INTEGRITETIT

Hartimi i Planit të Integritetit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit ka kaluar nëpër disa faza:

- **Faza e parë:** Drejtori i Agjencisë, me datë 28.09.2023, ka marr vendim për emërimin e Kryesuesit/Koordinatorit, Anëtarët e Grupit Punues për Hartimin e Planit të Integritetit, si dhe emërimin e personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit.

Gjatë kësaj faze, Kryesuesi i Grupit Punues, më 02.10.2023, përmes emailit, ka kërkuar nga të gjithë anëtarët e grupit punues që ta sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm varësisht nga përgjegjësit/divizionet që ata i mbulojnë, pasi që analizimi i tyre është i domosdoshëm me qëllim të identifikimit të faktorëve të rrezikut që cenojnë integritetin e Agjencisë, e që si rezultat do të kontribuojë për hartimin e Planit të Integritetit për APK.

Dokumentacioni ka përfshirë (ligjet, aktet nënligjore, rregullat për organizimin dhe sistematizimin, kodet e ndryshme, udhëzimet, udhëzuesit, raportet financiare, raportet e



auditimit, raportet e ndryshme vendore e ndërkombëtare për Agjencinë e disa shkrime e dokumentacione tjera mediale).

- **Faza e dytë:** Grupi punues ka zhvilluar një punëtori të përbashkët më 5 dhe 6 tetor 2023, ku ka shqyrtuar rregullativën ligjore të të gjitha akteve me qëllim që të identifikoj rreziqet brenda Institucionit.

Në këtë punëtori pjesëmarrësit janë ndarë në dy (2) grupe për identifikimin e rreziqeve për fusha të përgjithshme dhe fushave të veçanta, si dhe masat për eliminimin e tyre. Në fund të punëtorisë janë propozuar shumë rreziqe dhe masa për eliminimin e tyre.

Rreziqet dhe Masat e propozuara në këtë punëtori janë diskutuar përsëri me disa anëtar të grupit punues dhe disa propozime janë përshtatur në frymën e planit të integritetit.

Kryesuesi i Grupit punues, më 31.10.2023, ka përcjell draftin e planit për integritet te të gjithë anëtarët e grupit punues, me qëllim që përsëri të identifikojnë ose ti komentojë rreziqet dhe masat e propozuar si dhe planin në përgjithësi.

- **Faza e tretë:** Grupi punues pas gjithë kësaj ka përpiluar tabelat me rreziqe dhe ka propozuar masat për menaxhimin dhe eliminimin e rreziqeve si dhe më 7 nëntor 2023, përmes Koordinatorit të Grupit Punues, drafti i Planit për Integritet, përmes emailit është përcjellë në zyrën e Drejtorit me kërkesë për miratim.

Në fund të kësaj faze Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit ka miratuar dhe ka publikuar Planin e Integritetit për periudhën tre (3) vjeçare: (janar 2024- dhjetor 2026).

## 6. ANALIZA E AKTEVE NORMATIVE:

Grupi i punës kreu një analizë të të gjitha akteve normative që rregullojnë punën dhe detyrimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Aktet ligjore të analizuara:

- Ligji Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave;
- Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik;
- Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Aktet nën-ligjore në bazë të të cilave është organizuar puna e Agjencisë dhe të cilat janë të miratuara nga Agjencia:

- Rregullore Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Kodi Nr. 03/2013 i etikës për nëpunësit e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullore Nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullore Nr. 02/2014 për organizimin, funksionalizimin dhe menaxhimin e arkivit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullore Nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullore Nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

## 7. MATRICA E VLERËSIMIT TË INTENSITETIT TË RREZIKUT

<b>Pasoja /Ndikimi</b>	<b>Madhor</b>	10									
		9									
		8									
	<b>Mesatar</b>	7									
		6									
		5									
		4									
	<b>Vogël</b>	3									
		2									
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
<b>Intensiteti rrezikut (gjasat X ndikimi)</b>	<b>i</b>	<b>Ulët</b>			<b>Mesatar</b>			<b>Lartë</b>			
		<b>Probabiliteti/Gjasat</b>									

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të cenimit të integritetit vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

**Rreziku me intensitet të ulët** – mundësia e ndodhjes së cenimit të integritetit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit, (rreziku nuk u shfaq në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen).

**Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut** - Ndikimi për integritetin e institucionit është i parëndësishëm.

**Rreziku me intensitet të mesëm** – ndodhja e cenimit të integritetit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik, (rreziku është shfaqur në një numër rastesh në të kaluarën, kështu që probabiliteti i ndodhjes në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen është i moderuar).

**Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut** - Ndikimi i është i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

**Rreziku me intensitet të lartë** – cenimi i integritetit ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin, (rreziku është shfaqur shpesh në të kaluarën dhe ekziston një gjasë e madhe që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen).

**Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut** – Ndikimi është shumë i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

## 8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I ZBATIMIT TË PLANIT PËR INTEGRITET

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, përmes zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit për Integritet, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Agjencisë.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetëve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Personi përgjegjës për zbatimin e Planit të Integritetit, raporton lidhur me zbatimin e Planit të Integritetit, çdo gjashtë (6) muaj brenda Institucionit.

Raportimi duhet bërë mbi zbatimin e masave në mënyrën si më poshtë:

1. Masa është zbatuar në kohën e duhur;
2. Masa është zbatuar pas afatit;
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike.

## 9. MATRICA E IDENTIFIKIMIT TË RREZIQEVE

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut			Masat ndaj rrezikut			
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	<b>Udhëheqja dhe Menaxhmenti</b>	Cenimi i parimit të transparencës	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	5	15	Transparencë e plotë e procedurave vendimmarrëse në të gjitha fushat nën juridiksionin e Institucionit përmes publikimit të tyre në web-faqen e APK	Drejtori i APK	Në vazhdimësi
2.	<b>Politika e burimeve njerëzore</b>	Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate dhe të pa përditësuar	Aktet ligjore dhe aktet e brendshme nënligjore	3	7	21	Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës	Drejtori i APK-së dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi

		Identifikimi i pjeshëm dhe mungesa e trajnimeve profesionale adekuate		4	5	20	Organizimi i trajnime specifike profesionale bazuar në kërkesa.	Drejtori i APK-së dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
3.	<b>Planifikimi dhe Menaxhimi i Financave</b>	Procesi i dhurimit, tjetërsimit të pasurive jo financiare	Nuk ka rregullore të brendshme.	7	7	49	Hartimi i një akti të brendshëm për dhurim dhe tjetërsim të pasurive jo financiare	Drejtori i APK dhe Departamenti për Punë të Përgjithshme dhe Financa	6 muaj
		Planifikimi jo adekuat i buxhetit	Ligjet, aktet nënligjor; dhe aktet e brendshme të Institucionit	5	6	30	Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit		Në vazhdimësi
		Ruajtja fizike e dokumenteve zyrtare.	Mungesa e hapësirës së mjaftueshme.	4	6	24	Sigurimi i hapësirës për arkivë.		12 muaj
4.	<b>Ruajtja dhe siguria e të dhënave digjitale</b>	Mos Klasifikimi i të dhënave dhe kontrolli i qasjes.	Mungesa e një akti të brendshëm të APK-së, për klasifikimin dhe ruajtjen e të dhënave.	7	8	56	Hartimi i një akti të brendshëm për klasifikimin dhe ruajtjen e të dhënave elektronike.	Drejtori i APK-së dhe Njësia e TI-së	12 muaj
		Sigurimi i të dhënave elektronike dhe shërbimeve digjitale të APK-së.	Mungesa e resurseve të mjaftueshme teknologjike dhe stafit të TI-së.	3	6	18	Rekrutimi i stafit të TI-së, krijimi i një njësie të veçantë të TI-së për mbikëqyrjen e vazhdueshme profesionale.	Drejtori i APK-së dhe Njësia e TI-së.	2 vite
5.	<b>Prokurimi Publik i Agjencisë</b>	Përgatitje joefikase e	Ligjet, aktet nënligjore	4	5	20	Identifikimi i nevojave për trajnime për	Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi

		specifikimev e teknike					zyrtarët që përfshihen në procedurat e prokurimit publik		
--	--	------------------------	--	--	--	--	--	--	--

### FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT

FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i Rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	Konflikti i interesit	Mungesa e kriterëve specifike për ndarjen e rasteve	Rregullorja aktuale e punës, përveç ndarjes së rasteve në mënyrë proporcionale, nuk përcakton kriterë tjerë specifike për ndarjen e rasteve	7	9	63	Të përcaktohen kriteret specifike (standarde) për ndarjen e rasteve me rastin e hartimit të rregullores së re.	DPKI dhe Drejtori i APK-së	6 muaj
		Vështirësitë në përmbushjen e planit të punës për shkak të mungesës së stafit	Ekziston rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, por pozitave parapara me këtë rregullore nuk	6	6	36	Plotësimi i pozitave vakante të punës sipas rregullores në fuqi dhe shtimi i pozitave të reja në përputhje me dinamikën dhe planin e ri të punës		9 muaj

			janë të plotësuara.						
		Mungesa e rregullores së veçantë për parandalim të konfliktit të interesit në APK	Ekziston draft – Rregullorja	4	6	24	Aprovimi i rregullores së veçantë për parandalim të konfliktit të interesit për zyrtarët e APK-së.	6 muaj	
		Mungesa e kritereve formale për pranueshmeri të rastit	Rregullorja aktuale e punës nuk përcakton kriteret formale për pranueshmëri të rasteve	5	7	35	Përcaktimi i kritereve formale për pranueshmeri, me rastin e hartimit të rregullores së veçantë për hetime administrative.	12 muaj	
		Mungesa e një sistemi elektronik funksional për KI	Data baza e vjetër nuk është e përshtatshme konform ligjit të ri	4	7	28	Zhvillimi i modulit të veçantë për DPKI në sistemin DMSA	12 muaj	
<b>2.</b>	<b>Deklarimi i pasurisë</b>	Mungesa e rregullores për zhvillimin e kontrollës së plot dhe procedurave në DPK	Rregullorja aktuale e punës nuk përcakton kriteret specifike për kontroll të plotë	7	7	49	Hartimi i rregullores me specifikat e kërkuara.	DPK/Drejtori i APK-së	6 muaj
		Vështirësitë në zbatimin e planit të punës për shkak të mungesës së stafit	Ligji i ri për Deklarimin e Pasurisë ka rritur numrin e subjekteve deklaruese, ndërsa stafi mbetet ai paraprak.	4	5	20	Rekrutimi i stafit shtesë		9 muaj



		Ruajtja dhe arkivimi i dosjeve të deklarimit të pasurisë	Aktualisht dosjet mbahen në vende jo adekuate ku kanë qasje shumë persona	5	7	35	Krijimi i infrastrukturës për arkivimin dhe digjitalizimin e saj	Drejtori i APK-së	12 muaj
		Mos zhvillimi adekuat i sistemit DMSA	DMSA i pa kompletuar	5	7	35	Zhvillimi dhe funksionalizimi i moduleve në DMSA për nevoja të DPK-se		3 muaj
3.	<b>Dhuratat – Pranimi, regjistrimi dhe ekspozimi i tyre</b>	Mungesa e një rregulloreje/udhëzuesi të APK-së për dhuratat	Nuk ekziston	7	9	63	Hartimi i rregullores/udhëzuesit të veçantë për dhuratat	DPK/Drejtori i APK-së	6 muaj
		Ruajtja dhe evidentimi i dhuratave	Vetëm një zyrtar përgjegjës është duke i ruajtur në një zyre jo adekuate	4	6	24	Të caktohet një kënd i veçantë për ruajtjen dhe ekspozimin e tyre në pajtim me ligjin.	Drejtori i APK-së	6 muaj
		Mungesa e një sistemi elektronik për evidentimin e dhuratave.	Data baza aktuale nuk është e përshtatshme të përdoret për nevoja të regjistrimit të dhuratave	4	5	20	Përfshirja e deklarimit të dhuratave në sistemin e DMSA		6 muaj
4.	<b>Sinjalizimi</b>	Konfidencialiteti i informatës dhe identitetit të sinjalizuesit që raporton në APK, përmes emailit dhe telefonit.	Deklarata për ruajtjen e sekretit zyrtar  Ligji nr. 08/L-017 për Agjencinë për	6	8	48	Krijimi i një emaili të veçantë për pranimin e rasteve të sinjalizimit  Krijimi i një linje të veçantë telefonike	Departamenti për Luftimin e Korrupsionit /Njësia për mbrojtjen e sinjalizuesve	9 muaj

		Parandalimin e Korrupsionit  Ligji Nr. 06 /L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve  Rregullorja (QRK) - Nr.03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit				për pranimin e rasteve të sinjalizimit		
	Mosrespektimi i afateve dhe procedurës së paraparë për trajtimin e rasteve	Ligji Nr. 06 /L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Rregullorja (QRK) - Nr.03/2021, për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit	7	8	56	Forcimi i sistemit të kontrollit të:  -Njoftimeve për pranimin ose refuzimin e rasteve të sinjalizimit; -Vendimeve për vazhdimin e procedurës së hetimit administrativ, -Njoftimin për vazhdimin e procedurës së hetimit administrativ; -Njoftimeve për përfundimin e procedurës së hetimit administrativ.		Në vazhdimësi
	Mungesa e përvojës adekuate profesionale të zyrtarëve	Ligji dhe rregullorja përkatëse për sinjalizim	5	5	25	Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës përmes trajnimeve adekuate		Në vazhdimësi

		përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve.	Diskrecioni i punëdhënësit për caktimin e zyrtarit përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve.				për përpunimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit.  Ngritja e bashkëpunimit të APK-së me zyrtarët përgjegjës rreth ndarjes së praktikave të mira.		
5.	<b>Integriteti</b>	Monitorimi dhe raportimi mbi zbatueshmerinë e Planeve të Integritetit	Nuk ka ndonjë akt rregullues për raportimin monitorimin e planeve të Integritetit	4	6	24	Miratimi i një Metodologjie nga ana e APK-së për raportimin dhe monitorimin e Planeve të Integritetit.	Njësia përgjegjëse për Integritet dhe Drejtori i APK-së.	6 muaj
		Mungesa e përvojës adekuate profesionale	Stafi aktual nuk e ka përvojën e mjaftueshme	4	4	16	Avancimi i kapaciteteve profesionale dhe rritja e burimeve njerëzore		Në vazhdimësi
6.	<b>Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe vlerësimi i korrupsionit në legjislacionin</b>	Mungesë e përvojës adekuate profesionale	Vlerësimi i performancës.	6	7	42	Organizimi i trajnimeve/tryezave apo punëtorive adekuate	Njësia Përgjegjëse dhe Burimet Njerëzore	Në vazhdimësi

